



BASHKIA
REPUBLIKANË QIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr.41, datë 29.04.2020

**“PËR
KRIJIMIN E SHËRBIMIT VULLNETAR PËR MBROJTJEN NGA ZJARRI DHE
SHPËTIMIN NË BASHKINË TIRANË”**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 29, pika 2, nenit 54, shkronja “k”, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 13, pika 2, të Ligjit nr.152/2015, “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, Ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Ligjit nr. 45/2016, “Për vullnetarizimin”, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Krijimin e Shërbimit Vullnetar për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi në Bashkinë Tiranë.
2. Shërbimi vullnetar është pjesë e shërbimit të Drejtorisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi dhe ka një numër prej 70 (shtatëdhjetë) vullnetarësh.
3. Misioni i Shërbimit Vullnetar nga Zjarri dhe Shpëtimi ka si mision kryesor rritjen e angazhimit të vullnetarëve dhe shërbimit vullnetar për parandalimin dhe ndërhyrjen për shuarjen e zjarreve, shpëtimin e jetës, si dhe menaxhimin e fatkeqësive të tjera dhe zvogëlimin e pasojave të tyre në territorin e Bashkisë Tiranë.
4. Të miratojë strukturën e shërbimit vullnetar, sipas Aneksit nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
5. Shërbimi vullnetar drejtohet nga Komandanti i shërbimit vullnetar, i cili emërohet dhe shkarkohet nga kryetari i Bashkisë dhe është përgjegjës për funksionimin dhe administrimin e këtij shërbimi.
6. Të miratojë uniformën dhe shenjat dalluese të veçanta të shërbimit vullnetar, sipas Aneksit nr. 2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
7. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi do të përballohen nga buxheti i parashikuar për vitin 2020 për Drejtorinë e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi pranë Bashkisë Tiranë.
8. Të drejtat dhe detyrimet, kushtet dhe kriteret e nevojshme për kryerjen e aktiviteteve dhe shërbimeve vullnetare përcaktohen në kontratën e vullnetarizimit që lidhet midis Bashkisë Tiranë dhe anëtarëve të shërbimit vullnetar.
9. Në zbatim të pikës 7, të këtij vendimi, ngarkohet kryetari i Bashkisë ose personi i autorizuar prej tij për lidhjen e kontratës me vullnetarët.
10. Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet Drejtorisë së Përgjithshme të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi, Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe Shërbimit Kombëtar të Punësimit.
11. Ngarkohen kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit Strategjik dhe Burimeve Njerëzore, Drejtoria për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile dhe Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

K R Y E T A R

TONI GOGU

